



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:029880

Datë: 03.05.2024

Numri i dokumentit: 05650983

C.nr.213/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Genc Hasani, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh.L., të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Amir Bunjaku, avokat nga P., kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës, me objekt kontesti, Për anulimin e vendimeve të Policisë, nr. i vendimit ... të dt...., të Komisionit të Brendshëm Disiplinor si dhe vendimin nr...., lartësia e objektit të kërkesës 423.90 euro, jashtë seancës gjyqësore me datë 03.05.2024, jep këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit Sh. L., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, që të ANULOHOJ vendimin Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë – Komisionit të Brendshëm Disiplinor numër ..., të datës ... dhe vendimin numër ..., të datës ... si të kundërligjshme, dhe të DETYROHET e paditura që t'ia kthejë paditësit 25% të pagës mujore bruto për tre muaj në lartësi prej 423.90€ (katërqind e njëzet e tre euro e nëntëdhjetë cent), si e pa bazuar.

A r s y e t i m

Paditësi përmes përfaqësuesit të tij, me datë ..., ka paraqitur padi, të cilën e ka precizuar me datën ..., kundër të paditurës, ku si kërkesë përfundimtare ka qenë Anulimi i vendimeve nr. ..., të datës ... dhe numër ..., të datës ... si të kundërligjshme, duke kërkuar që të DETYROHET e paditura që t'ia kthejë paditësit 25% të pagës mujore bruto për tre muaj në lartësi prej 423.90€ (katërqind e njëzet e tre euro e nëntëdhjetë cent).

1. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Përfaqësuesi i paditësit në seancë dhe fjale përfundimtare me gjerësisht ka theksuar se pretendimi kryesor është që autorizimi në asnjë formë nuk mund dhe nuk është akt juridik me të cilin dikush mund të themelojë marrëdhënie të punës e meqenëse vendimet e policisë janë të bazuar në atë autorizim atëherë i ka propozuar gjykatës që në harmoni me ligjin t'i shpallë të kundërligjshme dhe ti anuloj. I ka prezantuar gjykatës edhe vendimin me nr. të referencës ... i datës ... që i ka paraprirë vendimit ... të datës ... (vendim për të cilin është tërhequr nga propozimi për administrim me vone) meqenëse bëhet fjalë për të njëjtën gjendje faktike si dhe provat dhe

autorizimet kanë qenë i njohur për drejtorin për hetime të brendshme dhe verifikim të së kaluarës vendimi ishte nxjerr që të pushoj procedura disiplinore ndaj Sh. L. duke konstatuar se nuk janë gjetur elemente të shkeljeve disiplinore, pastaj e paditura kishte rihapë procedurën disiplinore ndaj të njëjtit duke u thirrur në autorizimin noterial i datës ... të lidhur pranë noterit Dukagjin Dinaj me të cilën policia kishte konstatuar që ky akt juridik mund të shërbej si akt me të cilën paditësi ka lidhur marrëdhënie të punës e që rrjedhimisht ky vendim bie në kundërshtim me ligjin e punës dhe akteve të tjera që rregullojnë marrëdhënien e punës.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për taksë gjyqësore në vlere prej 20 euro, për përpilimin e padisë shumë prej 78 euro, për dy seanca nga 101.40 euro apo gjithsej shumë prej 300.80 euro.

E paditura me datë ..., ka parashtruar përgjigje në padinë me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetim se me vendimin e komisionit të brendshëm disiplinor ... datë ... paditësi është shpallur fajtor ku edhe i është shqiptuar masa disiplinore “ndalesë në pagë mujore 25% pagës bruto për 3 muaj”, kundër këtij vendimi paditësi ka ushtruar të drejtën e ankesës në komisionin për ankesa, komisioni për ankesa pas shqyrtimit të të gjitha provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës ka refuzuar ankesën si të pabazuar pasi për panelin e komisionit për ankesa vendimi i atakuar është i qartë dhe i kuptueshëm në kuptim të fakteve vendimtare dhe përmban arsye të mjaftueshme për masën e shqiptuar disiplinore duke konstatuar se edhe e drejta materiale është aplikuar drejtë në këtë çështje ankimore andaj në bazë të kësaj i propozojmë gjykatës që pas administrimit të provave padia dhe kërkesëpadia të refuzohet si e pabazuar dhe të lë në fuqi vendimet e të paditurës si të ligjshme. Sa i përket precizimit të kërkesëpadisë nuk e ka kundërshtuar.

Ne fjalën përfundimtare përfaqësuesja e të paditurës ka deklaruar: se në bazë të provave të lexuara është vërtetuar edhe një herë se vendimi i shkallës së parë të komisionit të brendshëm disiplinor si dhe vendimi i komisionit të ankesave ka qenë vendime të drejta dhe janë bazuar mbi Ligjin për Policinë dhe akte të tjera nënligjore ku është vërtetuar se paditësi ka kryer shkelje disiplinore në bazë të nenit 21 mosbindje e rëndë pika 1.14 si dhe të udhëzimit administrativ 04-2019 për shkelje dhe masa në procedurën disiplinore në policinë e Kosovës lidhur me nenin 43 të Ligjit për Policinë me c’rast nga komisioni i brendshëm disiplinor është shqiptuar masa disiplinore ndalesë në pagë 25% të pagës mujore bruto për tre muaj, i cili vendim është vërtetuar edhe me vendimin e komisionit të ankesave duke u bazuar në shkresat dhe provat e lëndës, andaj i propozojmë gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë në tersi si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

2. Gjendja faktike e vërtetuar

Me qëllim të vërtetimit në mënyrë të drejt dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me këtë çështje kontestuese, gjykata në procedurën e provave, në shqyrtimin gjyqësor-kryesor me datë ..., administroj këto prova: Autorizimi nr. LRP-nr. Ren. ...; Vendimi nr. ... i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Komisioni i Brendshëm Disiplinor; Vendimi nr. ... i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë, Komisioni për Ankesa; Lista e pagave për muajin mars, prill dhe maj të vitit 2022; Lista e punëtorëve për periudhën e vitit 2021 e datës ..., e lëshuar nga ATK; Raporti

përfundimtar i hetimit nr. Ref. ... për punëtorin Sh. L.; Raporti i përgjithshëm i hetimeve për rastin ...; Kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore e datës ...; Formulari i paraqitjes së disiplinës së brendshme i datës ...; Raporti i përgjithshëm i hetimit preliminar për rastin ...; Njoftimi lidhur me rastin me nr. ...; Raporti i veçantë i datës ...; Njoftim zyrtar për fillimin e hetimeve të brendshme i datës ...; Aktvendim i lëshuar nga UNMIK – Drejtorati për Administratën së Përgjithshme Sektori i Gjendjes Civile i datës ... nr. ...; Kontratë pune për kohë të caktuar në mes të NTP Motel Park dhe F. M. i datës ...; Certifikata e regjistrimit me nr. biznesi . në emër të N.P.H. Motel “Park”; Njoftim për largimin e aplikuesit S. R. i datës ...; Emaili drejtuar B. P. nga J.V.; Ftesa e datës ... për Sh. L.; Procesverbal mbi intervistën në lëndën hetimore me nr. ...; Procesverbal mbi intervistën e dëshmitarit / ankuesit në lëndën hetimore ... i datës ...; Procesverbal mbi intervistën e dëshmitarit në lëndën hetimore ...

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është **e pa bazuar**.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se: Në mes të palëve ndërgjyqësve nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura.

Nuk është kontestuese në mes të palëve se të paditurit i është bërë ndalesa në pagë prej 25%, për tre muaj të pagës bruto. Kjo gjë vërtetohet edhe nga lista e pagave për muajt Mars, Prill dhe Maj, të vitit 2022.

3. Baza Ligjore

Neni 85 i Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës Masat disiplinore për shkeljen e detyrave të punës përcakton: “1. Për shkeljen e detyrave të punës, të punësuarit do t’i shqiptohet njëra nga këto masa ndëshkuese: 1.1. vërejte me gojë; 1.2. vërejte me shkrim; 1.3. ulje në pozitë; 1.4. suspendim të përkohshëm; 1.5. ndërprerje të marrëdhënies së punës. 2. Masat ndëshkuese, vërejte me gojë, vërejte me shkrim dhe ulje, degradim të pozitës, do të shqiptohen për shkelje të lehta të detyrave të punës në pajtim me Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratën e Punës. 3. Masat ndëshkuese, suspendimi i përkohshëm dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës, do të shqiptohen për shkelje të rënda të detyrave të punës në pajtim me Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratën e Punës.” Që në rastin konkret Punëdhënësi në këtë rast Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, shkeljet e mundshme i ka pasur të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ nr. 04-2019 Për Shkelje dhe Masa në Procedurën Disiplinore në Policinë e Kosovës. Ndërsa, neni 86 Shqiptimin e masave përcakton “1. Vendimin për shqiptimin e masave ndëshkuese për shkeljen e detyrave të punës, e nxjerr: 1.1. organi kompetent i punëdhënësit apo punëdhënësi, 1.2. punëdhënësi i cili nuk e ka statusin e personit juridik ose personi të cilin ai e autorizon; 2. Autorizimi nga paragrafi 1. i këtij neni jepet me shkrim; 3. Vendimi i punëdhënësit duhet të bëhet me shkrim duke theksuar arsyetimin dhe

këshillën për mjetet juridike ndaj masave të shqiptuara.”. Ne rastin konkret e paditura ka nxjerre vendim, konform dispozitave ligjore dhe akteve nën ligjore lidhur me shqiptimin e masës disiplinore, ndaj paditësit Shaqir Lubaveci.

Neni 43 të Ligjit Nr. 04/L-076 Për Policinë, *“Procedurat disiplinore për personelin policor 1. Të gjitha shkeljet disiplinore, ku përfshihet punonjësi i Policisë së Kosovës, përveç rasteve të parapara në Ligjin për Inspektoratin Policor hetohen dhe vendoset nga Policia e Kosovës. 2. Shkeljet, masat dhe procedura disiplinore rregullohen me akt nënligjor.*

Gjykata, vlerëson se në këtë rast duhet të zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 04-2019 Për Shkelje dhe Masa në Procedurën Disiplinore në Policinë e Kosovës, për kërkesën e refuzuar të paditësit, që ka të bëjë me anulimin e vendimeve numër 605/KBD/'21, të datës 13.10.2021 dhe numër 1158-KA-2021, të datës 23.12.2021 si të kundërligjshme.

Me nenin 21 par. 1 nenpar. 1.14, të Udhëzimit Administrativ nr. 04-2019 Për Shkelje dhe Masa në Procedurën Disiplinore në Policinë e Kosovës përcaktohet se *“ Punonjësi i Policisë së Kosovës është fajtor për mosbindje të rënde nëse: Punësohet apo angazhohet pa aprovim paraprak në punë dytësore;”,* ky veprim sipas udhëzimit administrativ në fjale është mosbindje e rënde.

4. Vlerësimet e gjykatës

Nga interpretimi i dispozitës të lart cituar të Udhëzimit Administrative 04-2019, mbi veprimet e punonjësit të policisë për mosbindje, të nxjerr nga e paditura, dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar sepse paditësi në rastin konkret është angazhuar, përmes autorizimit të lëshuar nga pronari i N.P.H. Motel “PARK” S.Sh. që në emër të tij të përfaqësojë firmën e lartpërmendur. Dhe atë të kryejë veprime pranë Zyrrave Noteriale, Gjykatave kompetente, Doganave të Kosovës, Institucioneve shtetërore dhe atyre private apo organeve tjera përgjegjëse të nënshkruaj në emër të tij çfarëdo lloj kontrate (Marrëveshje)/AUTORIZIM për shitblerjen/përdorimin e automjeteve dhe të gjitha asetëve që janë prone e firmës së lartcekur, dhe autorizime të tjera..., këtë veprim të paditësit e paditura e ka trajtuar si shkelje të rënde – mosbindje e rënde në momentin kur e kupton se i njëjti ka marrë pjesë në një rrahje tek firma e lartpërmendur(N.P.H. Motel “PARK”). Andaj edhe të njëjtit në procedurë disiplinore i ka shqiptuar masën disiplinore **“Ndalese në pagë 25% të pagës mujore bruto për (3) tre muaj”**, vendim ky i mbetur në fuqi me vendimin ... të Komisionit të Ankesave të Policisë së Kosovës i datës ...

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e paditësit tek parashkrimi i veprës disiplinore të kryer, ku është thirrur në dispozitën nenit 70 të Udhëzimit Administrativ nr. 04-2019 Për Shkelje dhe Masa në Procedurën Disiplinore në Policinë e Kosovës, në të cilën përcaktohet *“Shkeljet e rënda disiplinore parashkruhen, nëse nga koha e kryerje apo marrjes në dijeni se është kryer shkelja kanë kaluar 4 vjet...”*, në rastin konkret e paditura ka kuptuar për shkeljen disiplinore pas rrahjes që kishte ndodhur me dt. 15.05.2021, rreth orës 18:15, në rrugën “Gazmend Baliu”, në Mitrovicë. Në rastin konkret vepra disiplinore është trajtuar brenda afatit, pasi që vendimi i Komisionit të

Brendshëm Disiplinore është lëshuar brenda afatit, paditësit i është dhënë mundësia e ankesës ne afatin prej 30 ditësh, i njëjti ka shfrytëzuar te drejtën e ankesës, pranë Komisionit për Ankesa te Policisë se Kosovës, me te cilin vendim i është refuzuar ankesa.

Gjykata vlerëson se Ministria e Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës, ka vepruar konform dispozitave ligjore te Ligjit për Policinë dhe akteve nënligjore siç është ne rastin konkret Udhëzimi Administrativ nr. 04-2019 Për Shkelje dhe Masa në Procedurën Disiplinore në Policinë e Kosovës, andaj, vendosi si ne dispozitiv te këtij aktgjykimi duke e refuzuar kërkesën e paditësit ne tërësi si te pabazuar.

Nga se u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
C.nr.213/2022, datë 03.05.2024

Gjyqtari,

Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.